

VENDIM
Nr. 301, datë 20.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 320, DATË 21.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE E TË KRITEREVE TË KONKURRIMIT DHE TË AFATEVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR MARRJEN E LEJEVE MINERARE NË ZONAT KONKURRUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 3, e 56, pika 1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 36/1, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 320, datë 21.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Shkronja "dh" e pikës 7.19, ndryshohet me këtë përmbajtje:

"dh. Të gjithë ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së subjektit fitues, pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). KPP-ja ndjek procedurat administrative të shqyrtimit dhe procedurat e hetimit administrativ, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik."

2. Pas shkronjës "dh", të pikës 7.19, bëhen shtesat si më poshtë vijon:

"dh/1. Ankesa, e paraqitur në rrugë elektronike pranë KPP-së nga çdo person që ka pasur një interes të ligjshëm në një procedurë për dhënien e lejeve minerare në zonat konkurruese, duhet të përmbajë dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse. Përgjithësisht, kur legjislacioni në fuqi parashikon një mjet tjetër komunikimi, ankesa e paraqitur pranë KPP-së shoqërohet me dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse në numër të llogarisë së KPP-së.

dh/2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në akte të tjera ligjore, për shqyrtimin e ankesës nga KPP-ja, subjekti duhet të paguajë 10% të vlerës së sigurimit të ofertës. Në rast se nuk është kërkuar sigurim oferte, subjekti duhet të paguajë 0.2% të vlerës së parashikuar të kontratës për marrjen e lejes minerare që ankimohet.

dh/3. Parapagimi i tarifës nga ankuesi përbën element të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës dhe moskryerja e tij është shkak për mospranimin e ankesës nga KPP-ja.

dh/4. Pagesa e tarifës i kthehet ankimuesit kur, në fund të procesit të ankimit, ankesa e tij pranohet. Kur ankesa nuk pranohet, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ankimit derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit."

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama